


	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna Skenderaj Opština Skenderaj –Municipality of Skenderaj	
---	--	---

**Komisioni Komunal i Aksionarëve i Ndërmarrjes Komunale Lokale-NPL,
“Eko-Natyra Sh.A” Skenderaj**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike si dhe Plotësim Ndryshimi i Ligjit me Nr.04/L-111, nenit 8 Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës dhe Vendimit të Qeverisë Nr.13/48 datë 07.12.2020 për Themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale, Komisioni Komunal i Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike “Eko-Natyra” Sh.A në Skenderaj, me datë **05.06.2024** shpall këtë:

KONKURS

**Për dy (2) pozita, Drejtorë të Bordit të Ndërmarrjes Publike Lokale
“Eko-NATYRA” Sh.A në Skenderaj**

KUALIFIKIMI DHE PËRSHTATSHMËRIA PROFESIONALE

Bazuar në nenit 17 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 kandidati për drejtor të bordit të ndërmarrjes publike lokale duhet të ketë kualifikimet dhe përvojën e punës, si në vijim:

- së paku pesë (5) vjet përvojë pune në nivel të menaxhimit në fushat e poshtëshënuara: në administrim të biznesit; financa korporative; financa; menaxhim të thesarit; banka; konsulentët në biznes; industri ose të ketë qenë së paku për 5 vjet kontabilist i certifikuar, jurist i kualifikuar, ose anëtar i kualifikuar i ndonjë profesioni tjetër që ndërlidhet me veprimtarinë afariste të Ndërmarrjeve Publike Lokale.

KUSHTET

Një person ka të drejtë të shërbejë si drejtor në Bordin e Ndërmarrjes Publike Lokale, nëse:

- nuk ka qenë i dënuar dhe nuk është nën hetime nga një gjykatë kompetente;
- nuk ka shkelur kodin etik apo standardet e sjelljes profesionale, përveç nëse një dënim i tillë është ndryshuar nga një gjykatë ose organ tjetër i ankesave;
- nuk ka bërë përgënjeshtime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim;
- nuk ka qenë në post menaxhues të ndonjë kompanie që ka falimentuar gjatë dhjetë (10) vjetëve të fundit.
- nuk punon në ndonjë institucion ku bëhen politikat zhvillimore për Ndërmarrjet Publike ku kandidati aplikon.

Kandidati nuk mund të zgjidhet drejtor në Bordin e Ndërmarrjes Publike Lokale, nëse:

- aktualisht është zyrtar, menaxher i Ndërmarrjes Publike përkatëse, ose cilëndo nga filialet e saj;
- ka shërbyer si zyrtar ose menaxher i Ndërmarrjes Publike përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj brenda pesë (5) vjetëve të kaluara;
- aktualisht ka, ose gjatë tre vjetëve të kaluara ka pasur, çfarëdo marrëdhënie materiale afariste (përveç si konsumator individual i shërbimeve të Ndërmarrjeve Publike) me Ndërmarrjen Publike përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë;
- është aksionar, drejtor ose zyrtar në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik, i cili ka marrëdhënie materiale afariste me Ndërmarrjen Publike përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;
- pranon, ose ka pranuar brenda tre (3) vjetëve të kaluara, kompensim shtesë nga Ndërmarrja Publike përkatëse ose cilado nga filialet e saj (përveç honorarit të Drejtorit ose kompensimit stimulues të përcaktuar në nenin 20.1 të Ligjit për Ndërmarrje Publike), ose është anëtar në skemën pensionale të Ndërmarrjes Publike përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;
- përfaqëson një aksionar i cili posedon mbi dhjetë për qind (10%) të aksioneve votuese në Ndërmarrjen Publike përkatëse;
- ka shërbyer në Bordin e Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike përkatëse më shumë se nëntë (9) vjet nga data e zgjedhjes së parë të tij/saj;
- është i afërm i shkallës së tretë (siç është konstatuar në përputhje me përkufizimin e “Interesit Financiar” në nenin 2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike) i cilitdo person që i takon cilëndo nga kategoritë e sipërpërmendura.
- është zyrtar, drejtor ose aksionar, ose ka një interes financiar në një shoqëri tregtare që konkurren me Ndërmarrjen, ose është menaxher i lartë, zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon më shumë se dy për qind (2%) të drejtave të votimit), ose ka një interes të konsiderueshëm financiar në cilëndo nga shoqëritë tregtare që konkurrojnë me Ndërmarrjen;
- është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 mujore para datës së aplikimit ka qenë zyrtar i zgjedhur publik, i emëruar politik ose bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;
- ka çfarëdo konflikti të interesave që për nga natyra, do të shkaktonte që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë rutinore, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t’i përmbushë detyrat e tij financiare ndaj Aksionarëve dhe Ndërmarrjeve Publike.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Kandidatët për drejtorë në Bordet e Ndërmarrjeve Publike duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Biografinë (CV-në)
- Deklaratën nën betim (formular, i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit)
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional, përvojës së punës)
- Certifikatën (dëshminë) që dëshmon se nuk është nën hetime
- Shtetas i Kosovës (kopje të pasaportës ose të letërnjoftimit).

Aplikuesi duhet të plotësoj personalisht deklaratën nën betim, me rastin e aplikimit, në të cilën deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësisë dhe të përshtatshmërisë profesionale. Çdo përgënjeshttrim material, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipërpërmendur, do të rezultojë në diskualifikimin e menjëhershëm.

Aplikacioni/Kërkesa merret si dhe dorëzohet e plotësuar dhe e kompletuar me të gjitha dokumentacionet tjera tek zyrat e NPL Eko Natyra Sh.A , ish objekti i TMK te pishat Skënderaj, prej orës 09:00 – 12:00 si dhe prej 13:00 – 15:00.

Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet. Origjinalet mund të kërkohen gjatë intervistës.

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë.

Kompensimi i drejtorëve të Bordeve të Ndërmarrjeve Publike Lokale do të bëhet në bazë të nenit 20 të Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe nenit 12 Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Inkurajohen të gjithë të interesuarit nga popullata jo-shumicë dhe të interesuarit që do të përfaqësojnë interesat e Komunës ku NP vepron, që të aplikojnë në konkursin për drejtorë të Bordeve të Ndërmarrjeve Publike.

Afati i konkursit është i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e publikimit në shtypin ditor (prej datës **05.06.2024** deri më datën **20.06.2024**)

Data:

05.06.2024

Komisioni Komunal i Aksionarëve:

Behxhet Maliqi, anëtar

Avdullah Geci, anëtar

Kushtrim Dragaj, anëtar

